



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI ADMINISTRATIV

Nr. 31001-01555-00-2015 i Regjistrit Themeltar

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Asim VOKSHI - Kryesues
Arbena AHMETI - Anëtare
Gentian MEDJA - Anëtar

Sot më datë 24.11.2022, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen administrative, që u përket palëve:

PADITËS: Adriatik Calaj

I PADITUR: Organi Administrativ pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimin e akteve administrative, vendim nr. 1017, datë 12.11.2014 Organit Administrativ pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, rregullimin e pasojave të shkaktuara nga këto akte.

BAZA LIGJORE: Nenet 121-129 i Kodit të Procedurës Administrative, të Ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 32/a, 153 të Kodit të Procedurës Civile.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarit Asim Vokshi, dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 7754, datë 24.12.2014 ka vendosur:

“Pranimin e kërkesë-padisë. Shfuqizimin e vendimit Nr. 11017, datë 12.11.2014, të palës së paditur Drejtorja e Policisë së Qarkut Tiranë”.

2. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 730 (28), datë 09.04.2015 ka vendosur:

“Mospranimin e ankimit të paraqitur ndaj vendimit nr. 7754, datë 24.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”.

3. Gjykata administrative e apelit ka arsyetuar se duke qenë se vlera e gjobës është nën kufirin e përcaktuar nga neni 45 i ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe

Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar), atëherë ndaj vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë nuk lejohet apel, ndonëse ndaj kundërvajtësit është disponuar edhe me masë administrative plotësuese të pezullimit të lejes së drejtimit të automjetit për një afat të caktuar. Kjo gjykatë e ka konsideruar këtë masë plotësuese administrative si aksesor të gjobës dhe për këtë shkak ka vendosur mospranimin e ankimit të të paditurit.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konstaton se në lidhje me këtë problematikë, ka praktika të ndryshme nga Gjykata Administrative e Apelit si dhe nga trupa të ndryshme gjykuese të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke filluar nga momenti i krijimit të gjykatave administrative e deri më sot. Thelbi i problematikës që nevojitet të njësohet në këtë rast, lidhet me faktin nëse në rastet kur policia e shtetit (organi përkatës kompetent) vendos masën ndëshkuese administrative me gjobë (e cila është nën vlerën e përcaktuar nga neni 45 i ligjit nr.49/2012) dhe njëkohësisht aplikon edhe një dënim plotësues, siç është pezullimi i lejes së drejtimit për një kohë të caktuar (apo zbritja e pikëve, kur gjen zbatim ky sanksion), a gjen zbatim kufizimi i vlerës i përcaktuar në nenet 45 e 56 të ligjit nr.49/2012 edhe për sanksionin plotësues, apo ky i fundit ndjek fatin e sanksionit me gjobë.

5. Në lidhje me sa më sipër, në referim të nenit 62/a të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (i ndryshuar), vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Administrativ për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përcakton çështjet e shtruara për njësim. Në këtë rast çështja është: “A do të zbatohen kufizimet e parashikuara nga nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, edhe për dënimin plotësues, në ato raste kur Policia e Shtetit, për kundërvajtjet administrative që lidhen me “shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor” të përcaktuara në Kodin Rrugor, vendos masën administrative dënim me gjobë dhe një dënim plotësues të papërcaktuar financiarisht siç mund të jetë ai i heqjes së lejes së qarkullimit rrugor?” Në këto kushte Kolegji vlerëson se çështja duhet të kalojë në seancë gjyqësore, pasi rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin e praktikës gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 58 dhe 62/a të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" (i ndryshuar),

VENDOSI:

1. Kalimin e çështjes administrative nr.31001-01555-2015.akti, për shqyrtim në seancë gjyqësore nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga 5 gjyqtarë.
2. Çështja që shtrohet për njësim është:
 - A do të zbatohen kufizimet e parashikuara nga nenet 45 dhe 56 të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, edhe për dënimin plotësues, në ato raste kur Policia e Shtetit, për kundërvajtjet administrative që lidhen me “shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor” të përcaktuara në Kodin Rrugor, vendos masën administrative dënim me gjobë dhe një dënim plotësues të papërcaktuar financiarisht siç mund të jetë ai i heqjes së lejes së qarkullimit rrugor?
3. Seanca gjyqësore caktohet më 27 janar 2023, ora 09.30.

4. Ky vendim ti njoftohet Avokaturës së Shtetit konform nenit 62/a(7) të ligjit nr.49/2012, me qëllim që të mund të paraqesë mendim me shkrim për çështjen dhe të njihet paraprakisht me aktet.
5. Të njoftohen palët për datën dhe orën e gjykimit të paktën 15 ditë para seancës gjyqësore.
6. Ky vendim të botohet në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, më datë 24.11.2022